



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 74, datë 22.04.2022

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Vendimin Nr.64, datë 15.04.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”” i ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Zoti Aurel Zarka**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
2. Zoti Aurel Zarka do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, nga data 27.04.2022 - 26.07.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Aurel Zarka do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Aurel Zarka, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 22.04.2022.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR**  
**ALFRED BALLA**

**ANËTAR**  
**SOKOL STOJANI**

**ANËTAR**  
**ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR**  
**ZEQIR HODA**

**ANËTAR**  
**BUJAR SHESHI**

**ANËTAR**  
**ESMERALDA KESHI**

**ZV/KRYETAR**  
**TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR**  
**NURIHAN SEITI**

**ANËTAR**  
**LUDOVIK DODAJ**

**ANËTAR**  
**MIRELA BOGDANI**